REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RADIO TELEVIZIONI SHQIPTAR
KËSHILLI DREJTUES NË RTSH

Nr. 2109/3 Prot.

Tiranë, më 12.10.2026

VENDIM
NR. 51 DATË 12.10.2026

Në zbatim të nenit 102, të Ligjit nr. 97, datë 04.03.2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar, nenit 17 të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 22.12.2016 "*Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)*", shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme me nr. 2109/2 prot., datë 08.10.2026, me lëndë *"Për miratimin e rregullores së Festivalit 65 të Këngës në RTSH""*, si dhe në vijim të procesverbalit të mbledhjes, mbajtur në datë 12.10.2026; nga ku Këshilli Drejtues pas procesit të rregullt të votimit dhe me shumicë votash:

V E N D O S I :

1. Të shtohet Inspektori i Skenës, Drejtori i Imazhit në organet drejtuese të Festivalit të 65-të Këngës, shoqëruar me detyrat përkatëse, si dhe të bëhet redaktimi gjuhësor për detyrat.
2. Të miratojë Rregulloren e Festivalit të 65-të të Këngës në RTSH, si akti themelor që përcakton të gjitha aspektet procedurale, organizative dhe krijuese të Festivalit të 65-të të Këngës në RTSH, sipas materialit bashkëlidhur.
3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm për ndjekjen dhe marrjen e masave administrative e financiare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI DREJTUES

Z. Fatjon Hoxhalli	Kryetar	
Z. Petrit Beci	Nënkryetar	
Z. Enio Civici	Anëtar	
Z. Pano Xhixho	Anëtar	(mungon)
Z. Alket Braho	Anëtar	
Znj. Zamira Kita	Anëtar	(mungon)
Z. Lorenc Vangjeli	Anëtar	
Z. Bujar Kapexhiu	Anëtar	
Z. Osman Mula	Anëtar	(mungon)
Znj. Rajmonda Bulku	Anëtar	
Z. Robert Budina	Anëtar	(mungon)